



6/6 KBU
12.10.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ERZEN

VENDIM

Nr.8, datë 25/09/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE “PËR KRYERJE SHPIMI
NËNTOKËSOR PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI)”**,
Z. AHMET KUKA

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Erzen,

VENDOSI:

1. Miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi) për qëllime sanitare dhe ujitje, z. Ahmet Kuka, me vendndodhje, Sauk, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin

- X=487405.6
- Y=4573811.2
- Z=181 m.m.n.d
- Prurja e kërkuar: $Q = 0.3$ l/sek.

- Thellësia e parashikuar =160 m
- Diametri 1 (mm) 300 - Thellësia nga 0.0 m në 5.0 m
- Diametri 2 (mm) 146 - Thellësia nga 5.0 m në 160 m

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU ERZEN

AFRIM QËNDRO

